

---

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" BELLAMARE " SHPK

---



Sot më datë 21.01.2024, në përputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Z. ABDYL DEMIRI ,shtetas Shqiptar, i lindur më 27.12.1962 në Gjon,MAT dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër identifikimi G21227067T themelon në cilësinë e Ortakut të Vetëm, Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "**BELLAMARE**" SHPK me përmbajtjen si më poshtë vijon:

## **KREU I**

### **FORMA JURIDIKE; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI**

#### **NENI 1**

#### **FORMA JURIDIKE**

- 1.1 Shoqëria "**BELLAMARE**" SHPK është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

#### **NENI 2**

#### **KOHËZGJATJA**

- 2.1 Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
- 2.2 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar qe fillon prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (më poshtë referuar si QKB).
- 2.3 Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të pezullojë ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

#### **NENI 3**

#### **ZYRA QENDRORE**

- 3.1 Zyra Qendrore e Shoqërisë ndodhet në adresën Lagjja " Ndërkru " banesë private 1-katëshe me nr.4, Martanesh , Bulqizë, Dibër , Shqipëri.
- 3.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.
- 3.3 Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.



**NENI 4**  
**OBJEKTI**

4.1 Shoqëria do të ketë për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

a) Bar, restorant, plazh privat, pishinë. Hoteleri dhe shërbime të tjera hotelerie që lidhen me akomodimin në hotel (furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese). Blerje, marrje ambjente me qera dhe veprime të tjera që lidhen me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë. Shitblerje dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë.

b) Import- Eksport të artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimorë, konfeksione, tekstile, produkte bujqësore dhe blegtorale, pajisje elektro-shtëpiake, hidrosanitare, pastrime kimike, detergjente të ndryshme, konfeksione rrobaqepsi, punime e shërbime të ndryshme në pastrime kimike, ushqimore, fruta perime, pije alkoolike, freskuese, mobilje, kozmetikë, lëndë të përpunuara e te papërpunuara të lëndëve medicinale, prodhimin e tregtimin e materialeve të ndërtimit,. Transport të udhëtarëve brenda e jashtë vendit. Realizim dhe administrim i shërbimit të lanterisë, pastrimit kimik, furnizimin me material hotelerie, materialeve një përdorimshe për entet publike dhe private.

4.2 Gjithashtu, për të realizuar objektivat e saj, shoqëria :

a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;

b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;

c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

4.4 Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet apo zvogëlohet në varesi të interesave të shoqërisë dhe në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.



**KREU II**  
**KAPITALI**

**NENI 5:**  
**KAPITALI THEMELTAR**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë i formuar në masë të plotë nga kontributi i ortakut dhe i ndarë ne një kuotë me vlerë nominale sipas ndarjes së mëposhtme. Cdo kuotë njësie ka të drejten e një vote. Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqerisë është në përputhje me kontributin e tij si me poshtë:

Ortaku themelues ABDYL DEMIRI, ,zotëruës i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themltar të shoqërisë.

**KREU III**  
**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

**NENI 6:**

Organet kryesore drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
- Administratori

**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**  
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe " ç " të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji



7.3 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **NENI 8**

### **MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 8.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 8.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 9**

### **KUORUMI**

- 9.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 9.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.
- 9.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 10**  
**MARRJA E VENDIMEVE**

- 10.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 10.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**NENI 11**  
**ADMINISTRIMI**

- 11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 11.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.



11.5 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë:

Z. TREJVI DEMIRI , shtetas shqiptar, i lindur në Kraste, Mat më 13.09.1997,  
identifikuar me pasaportën me nr. BB5567526 dhe numër personal  
J70913060M

## **NENI 12**

### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

12.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

## **NENI 13**

### **PERFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- (d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

**KREU IV**

**KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË,**

**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

**NENI 14**

**KONTROLI FINANCIAR**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**NENI 15**

**VITI FINANCIAR**

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 16**

**BILANCI VJETOR**

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 16.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 17**

**DIVIDENDI**

- 17.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 17.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.



**KREU V**

**PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE  
LARGIMI I ORTAKUT, DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 18**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 19**

**LIGJI I ZBATUESHËM**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 20**

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, kompetente do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor nën juridiksionin e së cilës shtrihet aktiviteti i shoqërisë.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**Neni 21**

**LARGIMI I ORTAKUT**

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun në bazë të dispozitave përkatëse të legjislacionit tregtar në fuqi.



**Neni 22**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Ne cdo rast, palët do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare" për zgjidhjen e çështjeve konkrete dhe te detajuara të cilat nuk janë përmendur specifikisht në këtë akt themelimi personi juridik.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe dhe pasi u miratua në parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqërisë, u nënshkrua rregullisht nga ai pa asnjë vërejtje.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**ABDYL DEMIRI**

